



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2023-10

**Prokurorja e Specializuar k. Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit dhe
Haxhi Shalës**

Vendosi: Trupi Gjykues I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, Kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 14 nëntor 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Konfidencial

Urdhër për Pezullimin e Afateve

T'i njoftohet:

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Sabit Januzit
Xhonatan Elistan Ris

Mbrojtjes së Ismet Bahtijarit
Felisiti Geri

Mbrojtjes së Haxhi Shalës
Tobi Kadman

TRUPI GJYKUES I (Trupi Gjykues) lëshon këtë urdhër për pezullimin e afateve.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 24 tetor 2024, Trupi Gjykues vendosi që gjykimi të fillonte më 14 nëntor 2024 dhe paraqitja e provave nga Zyra e Prokurorit të Specializuar të fillonte më 9 dhjetor 2024.¹
2. Më 11 nëntor 2024, ZPS-ja, Mbrojtja e Haxhi Shalës, Mbrojtja e Sabit Januzit dhe Mbrojtja e Ismet Bahtijarit (së bashku, Mbrojtja dhe të akuzuarit) njoftuan Trupin Gjykues se ishin në fazën e fundit të përfundimit të marrëveshjeve, për secilin prej të akuzuarve, për pranimin e fajësisë sipas rregullës 94 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (Rregullorja).²
3. Më 12 nëntor 2024, pas kërkesës së palëve, Trupi Gjykues shtyu seancat gjyqësore të 14 dhe 15 nëntorit 2024.³
4. Më 13 nëntor 2024, ZPS-ja informoi Trupin Gjykues se kishte lidhur marrëveshje për pranimin e fajësisë me secilin prej të akuzuarve dhe ia paraqiti këto marrëveshje Trupit Gjykues (Njoftimi sipas Rregullës 94).⁴
5. Gjithashtu, ZPS-ja dhe Mbrojtja, ndër të tjera, i kërkuan Trupit Gjykues “të pezullojë të gjitha afatet lidhur me parashtrimet aktuale” (Kërkesa).⁵

¹ KSC-BC-2023-10, F00559, Trupi Gjykues I, *Vendim mbi Datën e Fillimit të Gjykimit*, 24 tetor 2024, publik.

² KSC-BC-2023-10, F00587, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Përbashkët në lidhje me Rregullën 94*, 11 nëntor 2024, konfidencial, para. 1.

³ KSC-BC-2023-10, F00593, Trupi Gjykues I, *Urdhër për Shtyrjen e Seancave Gjyqësore*, 12 nëntor 2024, konfidencial, para. 5(a). Versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, F00593/RED.

⁴ KSC-BC-2023-10, F00596, Prokurori i Specializuar, *Njoftim URGJENT i Prokurorisë lidhur me Marrëveshjet për Pranimin e Fajësisë*, 13 nëntor 2024, konfidencial, para. 1, me Shtojcat 1-3 konfidenciale. Versioni i korrigjuar u dorëzua më 14 nëntor 2024, F00596/COR.

⁵ Njoftimi sipas Rregullës 94, para. 2.

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

6. Trupi Gjykues bazohet në nenin 40(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe rregullat 94 dhe 116(1) të Rregullores.

III. ANALIZË

7. Duke pasur parasysh nxjerrjen e marrëveshjeve me shkrim për pranimin e fajësisë, dhe pa paragjykuar vendimin e Trupit Gjykues mbi marrëveshjet në fjalë, Trupi Gjykues miraton Kërkesën dhe pezullon të gjitha afatet e caktuara më herët për parashtrimet e mëtejshme, me përjashtim të afateve që kanë lidhje me rishikimin e paraburgimit të të akuzuarve.

8. Trupi Gjykues gjithashtu u rikujton palëve detyrimin e tyre për t'iu përmbajtur afateve të përcaktuara për dorëzimin e versioneve të redaktuara publike të parashtrimeve të tyre, ose të kërkojnë riklasifikimin e tyre.

IV. VENDIM

9. Bazuar në arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykues:

- a. **MIRATON** Kërkesën; dhe
- b. **PEZULLON** të gjitha afatet e caktuara më herët për parashtrimet e mëtejshme, me kushtin e përcaktuar në paragrafin 7 më lart.

/nënshkrimi/
Gjykatëse Mapi Feld-Folia
Kryegjykatëse

/nënshkrimi/
Gjykatës Zhilber Biti

/nënshkrimi/
Gjykatës Roland Dekers

E enjte, 14 nëntor 2024

Në Hagë, Holandë.